



Prishtinë: 20.08.2018  
Kodi i ZRRE-së: V\_1024\_2018

## Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

### Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK\_V\_1835\_07\_18**;
- Ankesa e KESCO-së e datës **13.08.2018**.

### në seancën e mbajtur më datë 20.08.2018, nxori këtë:

#### V E N D I M

- I **REFUZOHET** ankesa e KESCO-së ndaj vendimit të DMK-së për konsumatorin B.G, nga Drenasi me shifër të konsumatorit: DPR - 90093222, si e pa bazuar.
- II **MBETET në fuqi** vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. ZRRE/DMK\_V\_1835\_07\_18 i datës 26.07.2018.

#### A r s y e t i m

Zyra e Rregullatorit për Energji me datë 04.06.2018 ka pranuar ankesën e parashtruar nga përfaqësuesi i autorizuar i KESCO-së, i cili ka kundërshtuar vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE si vendim i shkalës së parë për këto shkaqe: Përfaqësuesi i KESCO-së, në ankesë ka theksuar se në gjendja e shpenzimit të energjisë elektrike e njehsorit elektrik e evidentuar në procesverbalin e ndërrimit të njehsorit elektrik përputhet me gjendjen e shpenzimit të energjisë elektrike të muajit 02/2016. Analiza e bërë e DMK/ZRRE se konsumatori lidhur me shpenzimin e energjisë para dhe pas periudhës kontestuese se është afërsisht i njëjtë nuk mund të konsiderohet reale pasi ka dallim prej 40%, si dhe nëse merren në krahasim vetëm faturat e muajit janar të periudhave 2015, 2016, 2017 dhe 2018 shihet se ka dallim në shpenzim dhe se në asnjërën prej këtyre periudhave shpenzim nuk është konstant. Gjithashtu përfaqësuesi i KESCO-së, në ankesë ka theksuar sipas procesverbalit të kalibrimit, njehsori është brenda kufijve të lejuar të matjes dhe se gabimi në matje është -0.38% dhe se sipas kësaj mund të konstatohet se fatura e muajit 01/2016 është reale, si dhe fatura e muajit 01/2016 është në sezonën dimërore kur tejkalimi i shpenzimit nga ai i zakonshmi është i kuptueshëm dhe i arsyeshëm. KESCO në ankesën e tyre kanë theksuar se kërkojnë nga Bordi i ZRRE-së që pezullojnë vendimin e DMK-së ZRRE/DMK\_V\_1835\_07\_18 i datës 26.07.2018. për konsumatorin B.G. me shifër DPR - 90093222.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 20.08.2018 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuara nga palët në kontest si dhe vendimin e Departamentit për



Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.

Sa i përket pikës së kundërshtimit se gjendja e shpenzimit të energjisë elektrike e njehsorit elektrik e evidentuar në procesverbalin e ndërrimit të njehsorit elektrik përputhet me gjendjen e shpenzimit të energjisë elektrike të muajit 02/2016, Bordi i ZRRE-së ka analizuar me kujdes shkresat e lëndës dhe gjatë shqyrtimit të tyre, dhe ka theksuar se këtë konstatim e ka dhënë edhe organi i shkallës së parë respektivisht Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve në vendimin e tyre.

Sa i përket pikës së dytë të kundërshtimit se nuk duhet duhet të merret parasysh krahasimi i shpenzimit të energjisë elektrike para dhe pas periudhës kontestuese, Bordi i ZRRE-së thekson se kjo nuk qëndron sepse shpenzimi i energjisë elektrike është indikacion mjaft i rëndësishëm në shqyrtimin e lëndëve të konsumatorëve, andaj edhe duhet të merret parasysh edhe ky faktor. Bordi i ZRRE-së ka analizuar me kujdes shpenzimin e energjisë elektrike para dhe pas periudhës kontestuese, dhe sipas analizës së bërë shpenzimit të energjisë elektrike ka vërtetuar se mesatarja mujore e shpenzimit të energjisë elektrike të ky konsumator para dhe pas periudhës kontestuese është pothuajse konstante. Nga rrjedha e energjisë elektrike është vërtetuar se mesatarja mujore e shpenzimit të energjisë elektrike për periudhën para periudhës kontestuese 02/2014 e deri më 12/2015 është **1,134.65 kWh/muaj**, ndërsa mesatarja mujore e shpenzimit të energjisë elektrike për periudhën pas periudhës kontestuese 02/2016 deri më 12/2017 është **1,676.61 kWh/muaj**. Bordi i ZRRE-së gjithashtu ka bërë analizimin e shpenzimit të energjisë elektrike edhe sipas sezonave: dimërore dhe verore dhe ka konstatuar se nuk ka ndryshim në shpenzimin e energjisë elektrike mes sezonave para dhe pas periudhës kontestuese. Gjithashtu Bordi i ZRRE ka analizuar edhe kundërshtimin e KESCO-s në atë se nëse merren në krahasim vetëm faturat e muajit janar të periudhave 2015, 2016, 2017 dhe 2018 shihet se ka dallim në shpenzim dhe se në asnjërën prej këtyre periudhave shpenzim nuk është konstant, dhe ka vërejtur se shpenzimi i faturuar në këta muaj nuk është konstant por as për afërmi nuk është me shpenzimin e faturuar të muajit 01/2016 prej **8,452 kWh** ose llogaritur në vlerë financiare prej **812.73€**. Lidhur me këtë edhe Bordi i ZRRE-së konstaton se shpenzimi i faturuar për muajin 01/2016 prej 8,452 kWh nuk përputhet me gjendjen reale të shpenzimit të energjisë elektrike që bënë konsumatori, pasi që shpenzimi i energjisë elektrike para dhe pas kësaj periudhës kontestuese është i pothuajse i njëjtë.

Sa i përket pikës së kundërshtimit se sipas procesverbalit të kalibrimit, njehsori është brenda kufijve të lejuar të matjes dhe se gabimi në matje është -0.38% dhe se sipas kësaj mund të konstatohet se fatura e muajit 01/2016 është reale, Bordi i ZRRE-së ka analizuar me kujdes këtë procesverbal/protokoll, dhe ka vërejtur se punëtorët e autorizuar të kalibrimit në protokoll përveç tjerash kanë theksuar se njehsori elektrik nuk është në rregull, si dhe se kanë theksuar se njehsori elektrik është pa bllobë të ndarësit të tensionit. Lidhur me konstatimin e bërë se njehsori elektrik nuk është në rregull, punëtorët e autorizuar të kalibrimit nuk kanë dhënë detaje se për çka nuk është në rregull njehsori elektrik nr.1301674787 dhe se pse se njehsori elektrik është pa bllobë të ndarësit të tensionit, kur dihet se përgjegjës i njehsorit elektrik është Operatori i Sistemit të Shpërndarjes sipas nenit 54 të Ligjit për Energjinë Elektrike.

Bordi i ZRRE, gjithashtu ka konstatuar se përfaqësuesi i autorizuar i KESCO-së në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar pa ofruar prova të arsyeshme.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 20.08.2018 pas analizimit të krejt asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.



- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

**Këshillë Juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimi të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

**Bordi i ZRRE-së:**

\_\_\_\_\_  
Arsim Janova, u.d. kryesues

\_\_\_\_\_  
Besim Sejfiqaj, anëtar

\_\_\_\_\_  
Selman Hoti, anëtar

\_\_\_\_\_  
Izet Rushiti, anëtar

**Vendimi iu dërgohet:**

- KESCO-së, dhe
- Konsumatorit B.G. dhe
- Arkivit të ZRRE-së.